



Prishtinë, 03 tetor 2016
Kodi i ZRRE-së: V_851_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
- Kërkesën e KOSTT për aprovimin e amendamentimit të Rregullave të Ankandit për Alokimin e kapaciteteve interkonektive të Evropës Juglindore (EJL) të datës 14 shtator 2016,

në seancën e mbajtur me datë 03 tetor 2016, nxori këtë:

V E N D I M

- I Aprovohen amendamentimet në Rregullat e Ankandit për Alokimin e kapaciteteve interkonektive të EJL ver. 1.4**

Arsyetim

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 14 shtator 2016 ka pranuar kërkesën e KOSTT për aprovimin e amendamentimit të Rregullave të Ankandit për Alokimin e kapaciteteve interkonektive të EJL ver. 1.4.

Dokumenti është miratuar nga Bordi i Drejtorëve të PTC CAO SEE (*Project Team Company Coordinated Auction Office in the South East Europe*).

Fillimisht, ZRRE ka aprovuar dokumentin me datë 12 mars 2014 me vendimin V_615_2014. Dokumenti është rishikuar nga grupi punues që përbëhet nga përfaqësues të TSO-ve pjesëmarrëse. ZRRE pas vlerësimit të amendimeve të dokumentit dhe bazuar në kërkesën e KOSTT, konsideron se dokumenti me ndryshimet e bëra, i plotëson kriteret për kryerjen e aktivitetit të Ankandit për Alokimin e kapaciteteve për rajonin e përfshirë në dokument, prandaj bënë **Aprovimin e Rregullave të Ankandit për Alokimin e kapaciteteve interkonektive të EJL të amendamentuara.**

- II** Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- III** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Shtojcë: **Rregullat e Ankandit për Alokimin e kapaciteteve interkonektive të EJL ver. 1.4**

Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit KOSTT Sh.A.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Bordi i ZRRE-së

Krenar Bujupi, u.d. kryesuesit

Arsim Janova, anëtar

Qemajl Mustafa, anëtar

Besim Sejfiqaj, anëtar